

Kufiri si teknologji pushteti dhe regjim kontrolli, nga konceptualizimet teorike te mekanizmat e survejimit në Shqipërinë socialiste dhe RDGJ

Punoi: Dr. Blerina Fusha

Blerina Fusha është studiuese dhe profesioniste në fushën e shkencave politike dhe migracionit, me përvojë në administrimin dhe koordinimin e zyrave, menaxhimin e proceseve, koordinimin e projekteve arsimore ndërkombëtare, si dhe në mësimdhënie dhe kërkim shkencor universitar. Ajo ka përfunduar doktoraturën (PhD) në Migracion, Integrim dhe Multikulturalizëm në Universiteti i Tiranës gjatë periudhës 2014–2021, me temën: *“The modern state among the challenge of emigration and refugees”*. Është angazhuar në një sërë konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare:

- (2021) *Westernization, Europeanization and identity formation in the Western Balkan countries – Ligjërimi europian në Shqipëri*, në AAB International Virtual Academic Conference, Prishtinë.
- (2017) *Europeanization of Albania, Near or far?*, konferencë shkencore ndërkombëtare në Vlorë (ISBN: 2304-2664).
- (2021) *Is multiculturalism a solution for nowadays society?*, TWELFTH International Conference “Social and Natural Sciences – Global Challenge”, Berlin (ISBN: 978-9928-154-3-9).

Abstrakt

Ky punim shqyrton Sigurimin e Shtetit në Shqipëri (1944-1991) si një aparat kompleks pushteti dhe kontrolli shoqëror. Ai e vendos këtë në një perspektivë krahasuese me Ministrinë për Sigurinë e Shtetit (Stasi) në Republikën Demokratike Gjermane. Studimi bazohet në një qasje ndërdisiplinore që kombinon historinë politike, filozofinë e pushtetit dhe analizën institucionale të aparateve të sigurisë në regjimet komuniste.

Qëllimi është të kuptohet jo vetëm funksionimi represiv i këtyre institucioneve, por edhe logjika e tyre në organizimin e shoqërisë. Argumenti kryesor është se Sigurimi i Shtetit nuk duhet parë thjesht si një institucion represiv të izoluar, por si një aparat pushteti që krijoi kufij të shumëfishtë: fizikë, juridikë, socialë dhe psikologjikë. Në këtë kontekst, “kufiri” nuk është vetëm një vijë territoriale e sovranitetit shtetëror. Ai shfaqet si një regjim i përhapur kontrolli, që organizon rregulla, hierarki dhe forma të caktuara të subjektivitetit politik. Me këtë mekanizëm, qytetarët kategorizoheshin si “armiç”, “elementë të dyshimtë” ose “besnikë”, duke u përfshirë në një rend shoqëror të ndërtuar mbi frikën, survejimin dhe përjashtimin sistematik.

Korniza teorike e studimit mbështetet në tri perspektiva komplementare: konceptin e panoptikonit dhe pushtetin disiplinor të Michel Foucault-it, analizën e Hannah Arendt-it mbi marrëdhënien midis pushtetit, dominimit dhe shkatërrimit të hapësirës publike, si dhe nocionin e Giorgio Agamben-it mbi sovranitetin dhe normalizimin e “gjendjes së përjashtimit”. Këto qasje teorike ndihmojnë të kuptojmë se si praktikatat operative të Sigurimit të Shtetit – rekrutimi i bashkëpunëtorëve, mbikëqyrja e vazhdueshme, ndërtimi i dosjeve personale dhe presioni i padukshëm institucional – krijuan një formë kontrolli të brendësuar, ku individët

vetëdisiplinoheshin për shkak të pasigurisë dhe pamundësisë për të dalluar kufijtë realë të survejimit.

Në pjesën krahasuese, Stasi analizohet si një model paralel i survejimit të plotë, veçanërisht përmes praktikave si Zersetzung, të cilat synonin shkatërrimin psikologjik dhe social të individit, pa përdorur dhunë të hapur. Krahasimi nxjerr në pah dallimet strukturore, institucionale dhe teknologjike midis dy sistemeve, por gjithashtu ngjashmëritë thelbësore në logjikën e pushtetit: instrumentalizimin e ligjit, prodhimin e frikës, institucionalizimin e autocensurës dhe transformimin e jetës së përditshme në objekt administrimi dhe dokumentimi.

Në përfundim, ky studim argumenton se Sigurimi i Shtetit dhe Stasi nuk funksionuan vetëm si mekanizma ndëshkues. Ata vepruan gjithashtu si aparate që prodhuan “normalitetin” politik, duke krijuar kufij të brendshëm dhe të jashtëm. Këta kufij vazhdojnë të kenë pasoja psikologjike, sociale dhe ndërbrezore. Analiza krahasuese e tyre kontribuon në një kuptim më të thellë të mekanizmave të autoritarizmit dhe në proceset e edukimit historik dhe shërimit shoqëror.